



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS



TOP CHANNEL

TOP CHANNEL

Nr. 288/6 Prot., datë 25/09/2024

Nr. 545 Prot., datë 01/10/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Për

PALËT:

Media Audiovizive Top-Channel, në Adresën: Rruga "17 Nëntori", Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar: Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Lorela HOXHA; këtu, në rolin e **Ofruesit**, nga njëra anë,

dhe

Universiteti Bujqësor i Tiranës, në Adresën: 1029, Rr. Pajsi Vodica, Kodër - Kamëz, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. Edmond Tërthorja, në rolin e **Përfituesit**.

NENI 1

BAZA LIGJORE

Akt marrëveshja është përpiluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi: nenet 801 dhe vijues te Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 97/2013 "*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar), Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

NENI 2

PËRKUFIZIME

"Palë" do të thotë nënshkruesit e marrëveshjes, në cilësinë e ofruesit dhe përfituesit sipas Kontekstit të kësaj marrëveshjeje.

'Përfitues' do të thotë pala që do të përfitojë nga ofrimi i shërbimit (transmetim në median audiovizive) objekt i marrëveshjes.

"Ofrues" do të thotë pala që do të kryej shërbimet objekt i kësaj marrëveshjeje.





“E drejta e autorit” Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna të përfituesit këtu do t'i mbeten ofruesit.

NENI 3

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekti i kësaj Marrëveshje është vënia në dispozicion të personelit akademik që do të marrë pjesë dhe ambjenteve të UBT-së, nga “Universiteti Bujqësor i Tiranës”, për aktivitetin e pjesëmarrjes në emisionin televiziv “Bagëti dhe Bujqësi”, i cili do të transmetohet në median audiovizive, Top-Channel, duke nisur nga data 28.09.2024 për 10 puntata rradhazi.

NENI 4

AFATET E MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga Palët.
2. Kjo Marrëveshje do të përfundojë në mbarim të 10 puntatave të emisionit televiziv “Bagëti dhe Bujqësi”, i cili do të transmetohet çdo të shtunë në orën 10.30, në televizionin Top-Channel si dhe pas përmbushjes së detyrimeve reciproke të palëve.

NENI 5

VLERA E SHËRBIMIT DHE KUSHTET E PAGESËS

1. Vlera që përfituesi do të paguajë për shërbimin e ofruar nga ana e tij është në total prej **580.000 (pesëqind e tetdhjetmijë) lekë** duke përfshirë TVSH-në, sipas shërbimeve që do të ofrohen, bashkëlidhur kësaj akt-marrëveshje.
2. Paga e tarifës së shërbimit do të bëhet në llogarinë e ofruesit, si më poshtë:

Përfituesi: Top Channel

Emri i Bankës: Raiffeisen Bank sh.a

IBAN: AL36202110130000000100226091

SWIFT: SGSBALTX

Monedha: LEKE

3. Përfituesi do të kryej pagesën në llogarinë e ofruesit në mënyrën si më poshtë:

- a) Paga e kështit të parë prej 195,000 (njëqind e nentdhjetë e pesë mijë) Lekë përfshirë TVSH, do të kryhet brenda 5 diteve mbas transmetimit të puntatës së parë.
- b) Paga e kështit të dytë prej 195,000 (njëqind e nentdhjetë e pesë mijë) Lekë përfshirë TVSH, do të kryhet brenda 5 diteve mbas transmetimit të puntatës së pestë.





- c) Pagesa e kështit të tretë dhe të fundit prej 190,000 (njëqind e nentedhjetë mijë) Lekë perfshire TVSH, do të kryhet brenda 5 diteve mbas transmetimit të puntatës së dhjetë.

NENI 6

VONESA NË KRYERJEN E PAGESËS

Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamatën që fillon nga data e vonesës së debitorit (Përfituesit), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhetpagesa. Përqindja e kamatës parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Ofruesin) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (Ofruesi) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Përfituesi) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

NENI 7

DETYRIMET E PALËVE

1. Ofruesi është i detyruar të vendosë në dispozicion të gjitha shërbimet e kërkuara që janë objekt i kësaj Marrëveshjeje.
2. Ofruesi merr përsipër të transmetojë gjatë zhvillimit të emisionit televiziv, intervista me pedagoge të përcaktuar nga ana e Universitetit.
3. Ofruesi merr përsipër që gjatë transmetimit të emisionit televiziv, të shfaqë në ekran logo dhe pamje nga Universiteti.
4. Ofruesi merr përsipër që në fund të çdo puntate televizive të shfaq shkrimin “Ky emision u realizua në bashkëpunim me UBT-në”.
5. Përfituesi është i detyruar të paguajë në kohë shumën e specifikuar në këtë Akt Marrëveshje dhe të paguajë në mënyrën e specifikuar në Marrëveshje.
6. Në përfundim të aktivitetit, ofruesi (media televizive Top-Channel) është i detyruar të paraqesë dokumentimin e transmetimit në hard copy dhe online, objekt i kësaj Marrëveshjeje, të cilat ai / ajo i ka transmetuar për qëllimet e aktiviteteve të saj.
7. Ofruesi duhet të njoftojë paraprakisht të paktën 2 (dy) ditë personat e kontaktit të caktuar nga UBT, për kohën e realizimit të intervistave dhe filmimeve në ambjentet e Universitetit.

NENI 8

E DREJTA E AUTORIT

Nëpërmjet kësaj kontrate, përfituesi njeh dhe pranon se çdo lloj pronësie intelektuale apo e drejte mbi pronësinë intelektuale (në veçanti shpikjet, te drejtat e autorit dhe zbulimet e reja) të shpikura, zbuluara, krijuara apo përfituara gjatë e në zbatim të kësaj Marrëveshjeje të të gjithë puntatave, përfshire por pa u limituar në idete, konceptet, xhirime, intervista etj dhe të





gjitha punimet çdo lloj veprë ku ai do të jetë pjesëmarrës në kuptimin e legjislacionit shqiptar si për sa parashikohet në këtë marrëveshje për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, i kalojnë dhe janë në pronësi ekskluzive të ofruesit.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim që mund të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, zgjidhet me mirëkuptim mes palëve. Në rast se nuk gjendet zgjidhja me mirëkuptim e përbashkët, mosmarrëveshja zgjidhet sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 10

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Palët mund të shtojnë dhe/ose të ndryshojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje vetëm me mirëkuptim mes tyre. Pala që kërkon shtesa apo ndryshime, i bën kërkesë me shkrim palës tjetër. Shtesat dhe/ose ndryshimet e bëra në këtë marrëveshje janë të vlefshme vetëm nëse janë bërë me shkrim dhe janë nënshkruar nga të dyja palët.

NENI 11

PERSONAT E KONTAKTIT

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe në formë zyrtare.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj akt marrëveshjeje personat e kontaktit janë si më poshtë:

Personat e kontaktit për Universitetin: Znj. Ket Balliu me adresë email-i: ketiballiu@ubt.edu.al

Personat e kontaktit për median televizive Top-Channel: Rudina Muça

NENI 12

HYRJA NË FUQI E MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje:

- Hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.
- Përfundon me mbarimin e 10 puntatave televizive që do të transmetohen në emisionin “Bagëti dhe Bujqësi”, në median televizive Top-Channel, me plotësimin e detyrimeve reciproke nga palët.

Kjo Marrëveshje mbahet në 4 (katër) kopje, dhe nënshkruhet nga palët.

PËRFITUESI

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Përfaqësuar nga:

ADMINISTRATOR

Edmond FËRTHORJA



OFRUESI

TOP-CHANNEL

Përfaqësuar nga:

ADMINISTRATOR

Lorela HOXHA

LORELA HOXHA

